

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pesë të vrarë nga 'lufta me dronë' mes Arabisë Saudite dhe rebelëve Houthi
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/pese-te-vrare-nga-lufta-me-drone-mes-arabise-saudite-dhe-rebeleve-houthi-i586764
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 19:29:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 20:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9d1e2efa3009d74a686671431117f658f11e7cc0493b53cfc76efc7c23227f0
TEKSTI	feb9ef2316667b1439ef0e2b00e3a27483eef873ae3b1af2524e7f4a6e744b02
PAMJA	9d90c8f89e4a7bbc6c08b7b98096726a7d8bf06a55f86a9e213c8669ab8bcd4b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	431cf64a9fcd14c98ec6e8c2a987e27da81953a08842cdb70eba51fdb75bdd3a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/431cf64a9fcd14c98ec6e8c2a987e27da81953a08842cdb70eba51fdb75bdd3a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Kontakti me Iranin, Trump: SHBA-ja ka mbrojtur vendet e Gjirit/Shkaterrohet organizata shqiptare qe frymëzoj serialin "Marbella": Kapen 2.7 ton kokaine dhe arreshtohet fundit](#)

Pesë të vrarë nga 'lufta me dronë' mes Arabisë Saudite dhe rebelëve Houthi



17 Shtator 2026, 22:10Bota TEMA



Tensionet dhe sulmet e ndërsjella mes Arabisë Saudite dhe rebelëve Houthi të Jemenit janë përshkallëzuar ndjeshëm, duke lënë të paktën pesë të vrarë, mes të cilëve tre fëmijë.

Në Arabinë Saudite, mbrojtja ajrore interceptoi një dron të rebelëve Houthi në rajonin e Taif-it, por nga mbetjet e raketave humbi jetën një banor me kombësi jemenase dhe u plagosën dy të tjerë. Kjo shënon viktimën e parë të konfirmuar në territorin saudit për këtë muaj që nga nisja e valës së re të sulmeve.

Nga ana tjetër, në Jemen u raportuan disa goditje ajrore nga avionët sauditë dhe forcat aleate. Mediat e kontrolluara nga Houthit njoftuan se bombardimet dëmtuan tre kulla telekomunikacioni në provincën Taiz, ndërsa nga sulmet në Abs humbi jetën një civil. Po ashtu, ata akuzuan forcat e qeverisë jemenase të mbështetura nga Arabia Saudite për vrasjen e tre fëmijëve.

Përplasja ka nxitur edhe një luftë të fortë propagandistike. Arabia Saudite deklaroi se kishte asgjësuar një dron që kishte për qëllim qytetin e shenjtë të Mekës. Udhëheqësi i Houthive, Abdel-Malik al-Houthi, e hodhi poshtë këtë pretendim në një fjalim televiziv, duke e quajtur atë "një gënjeshtër të madhe" dhe propagandë për të arsyetuar agresionin saudit.

Zhvillimet kanë nxitur reagime diplomatike në rajon. Irani dënoi çdo sulm ndaj vendeve të shenjta islame, por kërkoi prova konkrete për akuzat ndaj Houthive, duke ngritur dyshime për operacione të mundshme me "flamur të rremë".

Ndërkohë, Kina u ka kërkuar privatistët zyrtarëve iraniane të ndikojnë tek Houthit për të ndalur sulmet, pas kërkesës për ndihmë nga Arabia Saudite. Nga ana tjetër, Pakistani dhe Turqia po shqyrtojnë zbatimin e marrëveshjeve të tyre të mbrojtjes me Rijadin, për shkak të përqesimit të sigorisë.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Konflikti me Iranin, Trump: SHBA-ja ka mbrojtur vendet e Gjirit!](#)

21:20 Bota / 1 koment

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin "Marbella": Kapen 2.7 ton kokainë dhe arrestohen 15 persona në Spanjë

21:10 Bota

[Rusët godasin anijen turke pranë kufirit me Rumaninë, raportohet për viktime](#)

19:50 Bota / 1 koment

[Eurodeputetja greke e ekstremit të djathtë sulmon ashpër Von der Leyen: Nuk ka raciste më të madhe kundër evropianëve se ju](#)

18:10 Bota / 12 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.